

VENDIM
Nr. 215, datë 26.5.2021

**PËR MIRATIMIN E TABELAVE STANDARDE ME TË DHËNA
STATISTIKORE TË NEVOJSHME PËR EFEKT TË VLERËSIMIT ETIK DHE
PROFESIONAL TË NDIHMËSMAGJISTRATIT NË GJYKATËN E LARTË**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 147, pika 1, shkronja “a” të Kushtetutës, nenet 2, 70, pika 3, 74–78, 84–95, 97 dhe 171 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 193, datë 12.5.2021, “Për miratimin e ‘Metodologjia e pikëzimit, me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë’” dhe nr. 194, datë 12.5.2021, “Për miratimin e ‘Rregullat e vlerësimit të gjyqtarëve të komanduar në Gjykatën e Lartë’”, me propozim të Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale,

VENDOSI:

1. Miratimin e tabelave standarde me të dhëna statistikore të nevojshme për efekt të vlerësimit etik dhe profesional të ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë, sipas formatit bashkëlidhur vendimit, pjesë përbërëse e tij (*lidhja 1*).

2. Tabelat hartohen në format shkresor dhe elektronik që kanë vlerë të njëjtë.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në Fletoren Zyrtare.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR
KRYETAR
Naureda Llagami

Lidhja 1

Tabela nr. 1 - Tabela për shpejtësinë dhe volumin e çështjeve gjyqësore me objekt “rekurs”, të përfunduara me vendim në dhomë këshillimi nga Gjykata e Lartë, Kolegji Civil/Penal/Administrativ.

Tabela nr. 2 - Tabela për shpejtësinë dhe volumin e çështjeve gjyqësore me objekt “kërkesa të tjera”, të përfunduara me vendim në dhomë këshillimi nga Gjykata e Lartë, Kolegji Civil/Penal/Administrativ.

Tabela nr. 3 - Tabela për shpejtësinë dhe volumin e çështjeve gjyqësore me objekt “rekurs”, të përfunduara me vendim në seancë gjyqësore nga Gjykata e Lartë, Kolegji Civil/Penal/Administrativ.

Tabela nr. 4 - Tabela për shpejtësinë dhe volumin e çështjeve gjyqësore me objekt “kërkesa të tjera”, të përfunduara me vendim në seancë gjyqësore nga Gjykata e Lartë, Kolegji Civil/Penal/Administrativ.

Tabela nr. 5 - Tabela për shpejtësinë dhe volumin e çështjeve gjyqësore me objekt “rekurs”, të përgatitura për relativim në pritje të gjykimit, Kolegji Civil/Penal/Administrativ.

Tabela nr. 6 - Tabela për shpejtësinë dhe volumin e çështjeve gjyqësore me objekt “kërkesa të tjera”, të përgatitura për relativim në pritje të gjykimit, Kolegji Civil/Penal/Administrativ.

Tabela nr. 7 - Tabelë përmblendhëse.

Tabela nr. 1

**TABELA PËR SHPEJTËSINË DHE VOLUMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE, ME OBJEKT
“REKURS” TË PËRFUNDUARA NË DHOMË KËSHILLIMI NGA GJYKATA E LARTË PËR
NDIHMËSMAGJISTRATIN _____, PËR VITIN _____
KOLEGJI _____**

[illegible]

Tabela nr. 2

**TABELA PËR SHPEJTËSINË DHE VOLUMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE, ME OBJEKT
“KËRKESA TË TJERA” TË PËRFUNDUARA ME VENDIM NË DHOMË KËSHILLIMI NGA
GJYKATA E LARTË, PËR NDIHMËSMAGJISTRATIN _____,
PËR VITIN _____
KOLEGJI _____**

[illegible]

Tabela nr. 3

**TABELA PËR SHPEJTËSINË DHE VOLUMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE ME OBJEKT
“REKURS”, TË PËRFUNDUARA ME VENDIM NË SEANCË GJYQËSORE NGA GJYKATA E
LARTË, PËR NDIHMËSMAGJISTRATIN _____, PËR VITIN _____
KOLEGJI _____**

[illegible]

Tabela nr. 4

**TABELA PËR SHPEJTËSINË DHE VOLUMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE ME OBJEKT
“KËRKESA TË TJERA”, TË PËRFUNDUARA ME VENDIM NË SEANCË GJYQËSORE NGA
GJYKATA E LARTË, PËR NDIHMËSMAGJISTRATIN _____,
PËR VITIN _____
KOLEGJI _____**

[illegible]

PËRMBAJTJA E TABELAVE NR. 1, NR. 2, NR. 3 DHE NR. 4

Tabelat nr. 1, nr. 2, nr. 3 dhe nr. 4 plotësohen me të dhënat statistikore, sipas rubrikave për çdo vit kalendarik të periudhës së vlerësimit dhe për çdo Kolegj të Gjykatës së Lartë, pranë të cilit ndihmësmagjistrati ka ushtruar veprimtarinë këshilluese dhe ndihmëse.

Lidhur me përmbajtjen e tabelave për shpejtësinë dhe volumin e çështjeve, sipas kolegjeve e ritit procedural të shqyrtimit në Gjykatën e Lartë, në secilën tabelë, për çdo çështje, plotësohen këto të dhëna:

“Nr.” është numri rendor.

“Nr. akti” është numri i aktit. Me qëllim lehtësimin e aksesit në dosje në këtë rubrikë duhet të plotësohet numri i plotë i regjistrit, duke vendosur numrin e regjistrit fizik dhe numrin e regjistrit elektronik të çështjes: p.sh., nr. regj fizik/nr. regj elektronik.

“Datë regjistrimi” është data në të cilën çështja është regjistruar në gjykatë.

“Datë caktimi/shorti” është data e caktimit të çështjes ose data e shortit është data e shortimit, elektronik ose manual, në raste të caktuara, për caktimin e ndihmësmagjistratin. Nëse çështja është caktuar më parë pranë një ndihmësmagjistrati tjetër dhe më pas, për arsye të ndryshme ndihmësmagjistrati ndryshohet, do të shënohet data e shortimit për caktimin e ndihmësmagjistratit që vlerësohet, i cili ka përfunduar çështjen.

“Datë relacioni” është data e përfundimit të dokumentit ligjor, analizë/opinion ... etj. nga ndihmësmagjistrati.

“Afati i përfundimit të relacionit” është periudha kohore nga data e marrjes së çështjes për përgatitjen e dokumentit ligjor (data e shortit për caktimin e ndihmësmagjistratit) deri në datën e përfundimit të dokumentit ligjor, i shprehur në ditë.

Krahasuar me “Standardin minimal kohor”. Në këtë kolonë bëhet shënimi nëse afati i përfundimit të dokumentit ligjor është brenda standardit minimal kohor të përcaktuar nga Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve ose kryetari i Gjykatës, duke bërë shënimin (+) ose (–) në rastet kur ky afat është respektuar ose tejkaluar.

Numër dhe datë vendimi (numri i vendimit sipas regjistrit manual të çështjeve dhe numri i prodhuar nga sistemi elektronik i menaxhimit të çështjeve: p.sh., nr. regj. fizik/nr. regj. Elektronik, si dhe data e shpalljes së vendimit nga kolegji përkatës i Gjykatës së Lartë.

Relator. Kolona “Relator” do të plotësohet duke shënuar emrin e gjyqtarit relator të caktuar për gjykimin e çështjes.

Tabela nr. 5

**TABELA PËR SHPEJTËSINË DHE VOLUMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE ME OBJEKT
“REKURS”, TË PËRGATITURA PËR RELATIV NË PRITJE TË GJYKIMIT, PËR
NDIHMËSMAGJISTRATIN _____,
PËR VITIN _____
KOLEGJI _____**

[illegible]

Tabela nr. 6

**TABELA PËR SHPEJTËSINË DHE VOLUMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE ME OBJEKT
“KËRKESA TË TJERA”, TË PËRGATITURA PËR RELATIM NË PRITJE TË GJYKIMIT PËR
NDIHMËSMAGJISTRATIN _____,
PËR VITIN _____
KOLEGJI _____**

<i>Nr.</i>	<i>Nr. akti</i>	<i>Datë regjistrimi</i>	<i>Datë caktimi/shorti</i>	<i>Datë relacioni</i>	<i>Afati i përfundimit të relacionit</i>	<i>Standard minimal kohor</i>	<i>Relator</i>

PËRMBAJTJA E TABELAVE NR. 5 DHE NR. 6

Tabelat nr. 5 dhe nr. 6 plotësohen me të dhënat statistikore, sipas rubrikave për çdo vit kalendarik të periudhës së vlerësimit dhe për çdo Kolegj të Gjykatës së Lartë, pranë të cilit ndihmësmagjistrati ka ushtruar veprimtarinë këshilluese dhe ndihmëse.

Lidhur me përmbajtjen e tabelave për shpejtësinë dhe volumin e çështjeve, sipas objektit/kategorisë, në secilën tabelë, për çdo çështje, plotësohen këto të dhëna:

“**Nr. ”** është numri rendor.

“**Nr. akti**” është numri i aktit. Me qëllim lehtësimin e aksesit në dosje në këtë rubrikë duhet të plotësohet numri i plotë i regjistrimit, duke vendosur numrin e regjistrimit fizik dhe numrin e regjistrimit elektronik të çështjes: p.sh. nr. regj. fizik/nr. regj. Elektronik.

“**Datë regjistrimi**” është data në të cilën çështja është regjistruar në gjykatë.

“**Datë caktimi/shorti**” është data e caktimit të çështjes ose data e shortit është data e shortimit, elektronik ose manual në raste të caktuara, për caktimin e ndihmësmagjistratit. Nëse çështja është caktuar më parë pranë një ndihmësmagjistrati tjetër dhe më pas, për arsye të ndryshme ndihmësmagjistratit ndryshohet, do të shënohet data e shortimit për caktimin e ndihmësmagjistratit që vlerësohet, i cili ka përfunduar çështjen.

“Datë relacioni” është data e përfundimit të dokumentit ligjor, analizë/opinion ... etj., nga ndihmësmagjistrati.

“Afati i përfundimit të relacionit” është periudha kohore nga data e marrjes së çështjes për përgatitjen e dokumentit ligjor (data e shortit për caktimin e ndihmësmagjistratit), deri në datën e përfundimit të dokumentit ligjor, i shprehur në ditë.

Krahasuar me “Standardin minimal kohor”. Në këtë kolonë bëhet shënimi nëse afati i përfundimit të dokumentit ligjor është brenda standardit minimal kohor të përcaktuar nga Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve ose kryetari i Gjykatës, duke bërë shënimin (+) ose (–) në rastet kur ky afat është respektuar ose tejkaluar.

Relator. Kolona “Relator” do të plotësohet duke shënuar emrin e gjyqtarit relator të caktuar për gjykimin e çështjes.

Tabela nr. 7

**TABELË PËRMBLEDHËSE ME TË DHËNA STATISTIKORE PËR SASINË, SHPEJTËSINË,
HEQJET DORË NGA ÇËSHTJET, PËR NDIHMËSMAGJISTRATIN
_____, PËR VITIN _____**

Nr.	Natyra e çështjeve, sipas rritit të shqyrtimit	Çështjet të caktuara për relativitet	Çështjet të papërfunduara	Çështjet e përfunduara	Rendimenti	Kërkesa për heqje dorë	Pranuar	Refuzuar
1	Rekurs, të përfunduara në db. këshillimi							
2	Kërkesa të tjera, të përfunduara në db. këshillimi							
3	Rekurs, të përfunduara në s. gjyqësore							
4	Kërkesa të tjera, të përfunduara në s. gjyqësore							
5	Rekurs, të papërfunduara							
6	Kërkesa të tjera, të papërfunduara							
TOTALI								

PËRMBAJTJA E TABELËS PËRMBLEDHËSE

Tabela përmbledhëse e të dhënave statistikore për çdo vit kalendarik, përmban:

Natyra e çështjeve. Kjo kolonë është e plotësuar dhe përmban llojin e çështjeve, sipas rritit të shqyrtimit.

Çështjet të caktuara për relativitet. Në këtë kolonë evidentohet numri i çështjeve të regjistruara në gjykatë, që i jepen ndihmësmagjistratit, me qëllim përgatitjen nga ana e tij të

dokumentit ligjor (analizë ligjore e çështjes, opinion ligjor dhe/ose material tjetër ndihmës lidhur me të, në funksion të relatimit nga ana e gjyqtarit në kolegji.

Çështjet të papërfunduara. Në këtë kolonë evidentohet numri i çështjeve për të cilat ndihmësmagjistrati ka përgatitur dokumentin ligjor, në funksion të relatimit nga ana e gjyqtarit në Kolegji, por që për arsye që lidhen me ecurinë procedurale të çështjeve në Gjykatën e Lartë, nuk është shqyrtuar ende nga kolegji përkatës.

Çështjet të përfunduara. Në këtë kolonë evidentohet numri i çështjeve për të cilat kolegji përkatës i Gjykatës së Lartë është shprehur me vendim, në dhomë këshillimi apo seancë gjyqësore.

Rendimenti. Rendimenti i përfundimit të dokumenteve ligjore për çështjet gjyqësore është raporti midis çështjeve të përgatitura për shqyrtim (të përfunduara + të papërfunduara) pavarësisht kohës së caktimit të tyre, me numrin e çështjeve të caktuara për përgatitjen e dokumentit ligjor, brenda një viti kalendarik. Ky tregues llogaritet automatikisht pas hedhjes së të dhënave.

Kërkesa për heqje dorë. Në këtë kolonë evidentohet numri i kërkesave për heqje dorë të paraqitura nga ndihmësmagjistratit.

Pranuar. Në këtë kolonë evidentohet numri i kërkesave për heqje dorë, të cilat janë pranuar nga kryetari.

Refuzuar. Në këtë kolonë evidentohet numri i kërkesave për heqje dorë, të cilat janë refuzuar nga kryetari.